



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.14, datë 26.01.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“PIKË KARBURANTI DHE KOMPLEKS SHËRBI MI NË RRUGËN TIRANË-ELBASAN,
JUG MJULL, BATHORE”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË


Në mbështetje të neneve neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.25, datë 03.12.2020 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Pikë karburanti dhe kompleks shërbimi në rrugën Tiranë-Elbasan, Jug Mjull, Bathore”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me propozim të subjektit zhvillues “Kastrati” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Pikë karburanti dhe kompleks shërbimi në rrugën Tiranë-Elbasan, Jug Mjull, Bathore”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Kastrati” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Rregullores së Vecantë i miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.25, datë 03.12.2020, mbetet i pandryshuar.
4. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

A circular official stamp in blue ink is positioned over the name. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHqipërisë" at the top, "MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" around the inner edge, and "TIRANË" at the bottom. A large, stylized handwritten signature in blue ink is written across the stamp and extends to the left.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

